

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës jep këtë:

URDHËRESË

1. Urdhëroj Drejtorinë për Inspektime që të mbikëqyrë në vazhdimësi zbatimin strikt të Rregullores në fuqi për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës të Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.
2. Në të gjitha rastet ku konstatohet se nuk është respektuar orari i punës nga ana e bizneseve, të ndërmerren masat e parapara konform dispozitave të kësaj rregulloreje dhe akteve tjera ligjore – nënligjore me të cilat është e rregulluar kjo çështje.
3. Drejtori i Drejtorisë së Inspektimeve duhet të paraqes raporte të rregullta me shkrim lidhur me zbatueshmërinë e orarit të punës nga bizneset e komunës të paraparë me këtë rregullore, përkatësisht, masat e ndërmarra nga inspektorët kompetent.
4. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Xhafer Tahiri

Kryetar i komunës

Urdhëresa i dërgohet:

- Drejtorisë për Inspektime,
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturave të Hotel "Amazona" SHPK, Komuna e Obiliqit për shpenzime të krijuara, si në vijim:
 - 1.1 Fatura nr. 9-SVH04-002-24086, datë 25.12.2019, në shumë prej 118.50 € (njëqind e tetëmbëdhjetë euro e pesëdhjetë cent), - drekë pune e kryetarit me disa zyrtar të komunës,
 - 1.2 Fatura nr. 20-SVH01-002-30, datë 20.01.2020, në shumë prej 30.50 € (tridhjetëeuro e pesëdhjetë cent), - drekë nga kryetari i komunës me përfaqësues të AQH-së,
 - 1.3 Fatura nr. 20-SVH01-002-31, datë 21.01.2020, në shumë prej 49.50 € (katërdhjetëenëntë euro e pesëdhjetë cent), - drekë nga kryetari i komunës me përfaqësues të kompanisë nga Kroacia SEEK,
 - 1.4 Fatura nr. 20-SVH01-002-50, datë 02.02.2020, në shumë prej 186.00 € (njëqind e tetëdhjetëe gjashtë euro), - drekë nga kryetari i komunës me përfaqësues të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe disa anëtar të KKK-së me rastin e pjesëmarrjes në akademinë përkujtimore në Vushtrri.
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës, në llogarinë bankare të paraqitur në fatura të cilat janë të bashkëngjitura në shtojcë të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA/REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI
VUSHTRRI MUNICIPALITY /OPSTINA VUCITRN

Në bazë të nenit 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe nenit 4, dhe neni 10 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, si dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës si organ shpronësues me datën 10.02.2020 merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

Neni 1

KONSTATOHET se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1 deri 1.4, paragrafi 1 i nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, për shpronësimin e pronës së paluajtshme për qëllim të përfitimit të ligjshëm publik-realizimi i projektit për ndërtimin e rezervuarit të ujit (Basenit) në fshatin Taraxhë, Komuna Vushtri për pjesën e parcelave kadastrale si në vijim:

- P-70202064-00083-0, në sipërfaqe prej 1027 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 8981 m², ZK-Taraxhë, pronar në pjesë ideale 1/1 Emin (Selim) Selimi nga fshati Taraxhë, Komuna Vushtri.
- P-70202064-00085-0, në sipërfaqe prej 502m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 18313m², ZK Taraxhë, pronar në pjesë ideale 1/1 Hasan (Emin) Selimi, nga fshati Taraxhë, Komuna Vushtri.

Neni 2

Brenda 5 ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, do të njoftohet me vendimin preliminar pronari/zotëruesi i interesit të pronës e cila do të shpronësohet.

Neni 3

Brenda 10 ditëve të punës pas miratimit, vendimi preliminar do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në Gazetën ditore "Zëri" në Kosovë.

Neni 4

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë brenda 15 ditëve pas hyrjes në fuqi, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, konform nenit 35 paragrafi 3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010. Ankesa mund të paraqitet nga pronari ose zotërues i interesit në pronën e prekur nga ky vendim. Në të njëjtën ditë në të cilën dorëzohet ankesa në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejt të dorëzoj në zyrën ligjore të organit shpronësues (Komunës së Vushtrisë) 5 (pesë) kopje të sakta dhe të plota të ankesës, duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse që e arsyetojnë ankesën.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare dhe në Gazetën ditore “Zëri” në Kosovë.


Kryetari i Komunës
Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	121/20
Nr. i fq. / Br. si	-02-
Data: / Datum	10.02.2020
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA VUÇITRN

Na osnovu člana 11 i 13 Zakona o Lokalnom Samoupravljanju br. 03/L-040, člana 4,i člana 10, Zakona o Eksproprijaciji Nepokretne Imovine Br. 03/L- 139 sa izmenama i dopunama Zakona Br. 03/L-205 dana 28.10.2010 god, kao i člana 67 "g" Statuta Opštine, Predsednik Opštine, kao eksproprisani organ dana 10.02.2020. god, donosi ovu:

PRELIMINARNU ODLUKU

Član 1

UTVRĐENO da su ispunjeni uslovi navedeni u narednim paragrafima 1.1 do 1.4, paragraf 1, član 4 Zakona o Eksproprijaciji Nepokretne Imovine br. 03/L-139 sa izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-205 od dana 28.10.2010 god, o eksproprijaciji nepokretne imovine, u cilju zakonske javne koristi, realizaciji projekta za izgradnju rezervoara za vodu (Bazena) u selo Tarade, Opština Vuçitrn za deo katatarske parcele kao što sledi :

- P-70202064-00083-0, u površini od 1027m², od ukupne površine od 8981 m². KZ-Tarade, sa vlasnikom na idealnom delu 1/1 Emin (Selim) Selimi iz sela Tarade, Opština Vuçitrn.

Član 2

Unutar 5 radnih dana posle usvajanja ove odluke, biće informisan preliminarom odlukom vlasnik/nosilac imovine koja će se eksproprisati

Član 3

Unutar 10 radnih dana posle usvajanja,preliminarna odluka biće objavljena na Službenom Listu Republike Kosova i na Dnevnom Listu "Zeri " na Kosovu.


Član 4

Protiv ove odluke može se podneti žalba unutar 15 dana posle stupanja na snazi, u Opštinskom Sudu u Mitrovici Grana u Vučitrnu, u skladu člana 35 paragraf 3, Zakona o Eksproprijaciji Nepokretne Imovine Br 03 L/139 sa izmenama i dopunama Zakona br.03/L-205 dana 28.10.2010.god. Žalba se može podneti od vlasnika ili nositelja interesa po ovoj odluci. U istom danu kada se predaje žalba u Sudu, podnosilac žalbe treba odmah i direktno predati u Zakonskoj Kancelariji organa eksproprijacije (Opštini Vučitrn) 5 (pet) tačnih i punih kopija žalbe, uključujući sve prateće dokumentacije koji opravdavaju žalbu.

Član 5

Odluka stupa na snagu danom objavljivanja na Službenom listu i na Dnevnom listu "Zeri" na Kosovo.


Xhafer Tahiri
Predsednik Opštine



/RKS-Logo/

/Vushtrri-Logo/

REPUBLIC OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

Pursuant to Articles 11 and 13 of the Law on Local Self-Government no. 03 / L-040, and Article 4, and 10 of the Law on Expropriation of Immovable Property, Nr. 03 / L-139 as amended by Law No.03 / L-205 dated 28.10.2010, as well as Article 67 (g) of the Municipality Statute, the Municipality Mayor as an expropriation body on 10.02.2020 take this:

Preliminary Decision

Article 1

Concluded that the conditions set out in sub-paragraphs 1.1 to 1.4, paragraph 1 of Article 4 of the Law on Expropriation of Immovable Property, Nr. 03 / L-139 with amendments and supplements to the Law No.03 / L-205 of 28.10.2010, on the Expropriation of Immovable Property for the Purpose of Lawful Public Benefit - Implementation for the Water Reservoir (Basin) Construction Project in the village of Taraxhë, Vushtrri Municipality for the following cadastral parcels:

- P-70202064-00083-0-0, total area of 1027 m², total area of 8981 m², ZK-Taraxhë, owner of ideal part 1/1 Emin (Selim) Selimi from Taraxhë village, Vushtrri Municipality.
- P-70202064-00085-0, 502m², 18313m² total area, ZK Taraxhë, owner of ideal part 1/1 Hasan (Emin) Selimi, from Taraxhë village, Vushtrri Municipality.

Article 2

Within 5 business days after the adoption of this decision, the owner / owner of the property interest who will be expropriated will be notified of the preliminary decision.

Article 3

Within 10 working days of approval, the preliminary decision will be published in the Official Gazette of the Republic of Kosovo and in the "Zeri" daily newspaper in Kosovo.


Article 4

This decision can be appealed within 15 days after its entry into force, in the Basic Court in Mitrovica-Branch in Vushtrri, pursuant to Article 35 paragraph 3 of the Law on Expropriation of Immovable Property, no. 03 / L-139 with amendments and supplements to the Law No.03 / L-205 dated 28.10.2010. The appeal may be filed by the owner or owner of the interest in the property affected by this decision. On the same day as the appeal is filed with the Court, the

complainant must immediately and directly submit to the legal office of the Expropriation Authority (Municipality of Vushtrri) 5 (five) complete and accurate copies of the appeal, including all the supporting documents justifying the complaint.

Article 5

The Decision shall enter into force on the day of its publication in the Official Gazette and in the "Zeri" Daily Newspaper in Kosovo.

Municipality Mayor

Xhafer Tahiri

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRË

02 Nr. / Br 122 / 20

Nr. i fq. / Br. sf _____

Data: / Datum 10.02.2020

VUSHTRRI - VUÇITRË



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e shpenzimeve nga buxheti i komunës për realizim të vizitës zyrtare të kryetarit të komunës dhe shefit të kabinetit të kryetarit në Shtetin e IOWA-s – SHBA, nga data 23 shkurt deri më 01 mars 2020 (shpenzimet e rrugës dhe akomodimit).
2. Mjetet buxhetore për realizim të kësaj vizite në shumë prej 4,890.00 € (katërmijë e tetëqind e nëntëdhjetë euro) të paguhet nga kategoria mallra dhe shërbime të njësisë buxhetore e cila ka mjete financiare të mjaftuara.
3. Pagesa e mjeteve nga pika paraprake e këtij vendimi të bëhet në llogarinë bankare të Odës Ekonomike Amerikane në Prishtinë e cila do të udhëheqë delegacionin e tri komunave të Kosovës (Vushtrri, Mitrovicë dhe Skenderaj) gjatë kësaj vizite. Numri i llogarisë bankare është bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë.